

NJË ANALIZIM MBI KONCEPTET E ZINXHIRËVE USHQIMORË NË KURRIKULËN BIOLOGJI AML ME ANË TË PYETËSORIT TË NXËNËSVE

ERMIRA DOKU.¹, ELTJON HALIMI²

¹Shkolla 9-vjeçare ‘Bakushe Visha’, Fushë-Krujë

²Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Biologjisë

e-mail: ermira.doku@gmail.com

Përmbledhje

Në këtë studim kemi marrë në shqyrtim përfundimin e njohurive dhe kompetencave për konceptet shtazore mbi ‘zinxhirët ushqimorë’ në kurrikulën e Biologjisë së Arsimit të Mesëm të Lartë (AML). Këto njohuri ndihmojnë jo vetëm në të kuptuarin e kurrikulës mësimore, por edhe në përfundimin e njohurive për faunën shqiptare dhe mbrojtjen e mjedisit. Për këtë janë marrë në analizë SPSS pyetësorët në një kampion prej 350 nxënësish në 2 shkolla të mesme, ‘I. Qemali, Tiranë, dhe ‘Shote Galica’, Fushë Krujë, gjatë vitit akademik 2017 – 2018. Mbështetur në kurrikulën e Biologjisë në pyetësor kemi listuar pyetje të mbyllura me alternativë, dhe një pyetje me përgjigje të hapur. 63 nxënës ose 46.6% të shkollës ‘Sh. Galica’ mendojnë që koha për konceptet shtazore mbi ‘zinxhirët ushqimorë’ është plotësisht e mjaftueshme; kurse në shkollën ‘I. Qemali’, një përgjigje të tillë e japin 88 nxënës ose 50%; 67 nxënës (49.62%) nga ‘Sh. Galica’ dhe 84 nxënës (47.72%) nga ‘I. Qemali’ mendojnë që metodika është plotësisht e mjaftueshme; 48 nxënës (36%) nga ‘Sh. Galica’ i njohin konsumatorët ‘mjaftueshëm’ ose ‘plotësisht’; ndërsa 70 nxënës (40%) nga ‘I. Qemali’, nuk i njohin konsumatorët. Vihet re dallim i qartë mes nxënësve të shkollës ‘I. Qemali’, të cilët njohin shumë pak konsumatorë të vendit apo të zonës; kurse, nga nxënësit e ‘Sh. Galica’ ka njohje më të plotë të tyre, për shkak se ndodhet më afër habitateve natyrore. 66% e nxënësve të ‘Sh. Galica’ dhe 65% e nxënësve të ‘I. Qemali’ sugjerojnë ekskursionet si metodikë për të kuptuar më mirë konceptet për zinxhirët ushqimorë; nga kjo mund të kuptohet se ka mangësi në zhvillimin e tyre. Ne mendojmë se shtimi i kohës së laboratorëve dhe ekskursioneve do të rriste më shumë njohuritë dhe kompetencat e nxënësve; kjo do të ndihmonte nxënësit e shkollës ‘I. Qemali’ të kenë më shumë mundësi për njohje reale të konsumatorëve dhe të faunës të vendit.

Fjalëkyçe: Koncept, zinxhir ushqimor, kompetencë, metodikë, kurrikul AML.

Abstract

The acquisition of knowledge and competences for animal concepts on ‘foodchains’ in the Biology curriculum in the Higher Education Secondary (AML) is analyzed here. It help not only in understanding the curriculum, but also in gaining knowledge about Albanian fauna and environmental protection. Hence, the SPSS questionnaires were analyzed in a sample of 350 students in 2 secondary schools, ‘I. Qemali’, Tirana, and ‘Shote Galica’, Fushë Kruja, during the academic year 2017 - 2018. Based on the Biology curriculum, in the questionnaire we have listed alternative closed questions, and an open-ended question. 63 students or 46.6% of the ‘Sh. Galica’ think that the time for animal concepts on ‘food chains’ is completely

sufficient; while at school 'I. Qemali', such answer is given by 88 students or 50%; 67 students (49.62%) from 'Sh. Galica' and 84 students (47.72%) from 'I. Qemali' think that the methodology is completely sufficient; 48 students (36%) from 'Sh. Galica' know consumers 'enough' or 'fully'; while 70 students (40%) from 'I. Qemali', do not recognize consumers. There is a clear distinction between 'I. Qemali' students, who know very few consumers from the country or nearby area; whereas, by the students of 'Sh. Galica' has fuller knowledge of them, probably because it is closer to natural habitats. 66% of 'Sh. Galica' and 65% of 'I. Qemali' students suggest excursions as a method to better understand concepts for food chains. It can be deducted that there are shortages in this issue. We think that adding more time to the labs and excursions would increase more the student's knowledge and competencies; it would help 'I. Qemali' students to have more opportunities for realistic recognition of the country's consumers and fauna.

Key words: Concept, food chain, competence, methodology, curriculum.

Hyrje

Biologjia është një ndër shkencat me zhvillimin më të shpejtë që gjen gjerësisht edhe zbatim praktik në bujqësi, mjekësi, bioteknologji etj. Studimi i biologjisë në shkollë është pjesë e rëndësishme e edukimit arsimor të nxënësve, që duke u integruar edhe lëndë të tjera të shkencave të natyrës ndihmojnë në aftësimin e nxënësve për të nxënë gjatë gjithë jetës, në përgatitjen e tyre për procesin e vendimmarrjes, për të marrë vendime të rëndësishme në jetën e përditshme duke u bazuar në njohuritë, aftësitë dhe shprehitë shkencore të fituara gjatë arsimit të mesëm të lartë.

Biologjia kontribuon në formimin e mendimit kritik, shkencor dhe në formimin e qëndrueshëm të dijeve. Si një shkencë e bazuar në mbledhjen e informacionit bazuar në vëzhgime dhe eksperimente, biologjia gjithashtu kontribuon edhe në formimin e kulturës së individit që me anë të veprimeve individuale ndikon në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.

Me anë të zhvillimit të kurrikulës së biologjisë, nxënësi ndërjegjësohet për ndikimin që veprimtaria e njeriut ka në ekosisteme, por edhe për rëndësinë që zinxhirët ushqimorë kanë në ruajtjen e ekuilibrave biologjikë dhe mundësimin e jetës me anë të tranferimit të energjisë nëpër hallkat e zinxhirëve ushqimorë.

Përvetësimi sa më mirë i koncepteve të lidhura më zinxhirët ushqimorë varet edhe nga veprimtaritë praktike dhe ekperimentale, të cilat zbatohen në shkollë. Por gjithashtu, një rol të madh luan edhe një mësimdhënie e suksesshme. Suksesi në kurrikulën e biologjisë gjen shprehje konkrete në përdorimin e metodave, strategjive dhe teknikave mësimore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Roli i mësuesit mbetet i rëndësishëm, jo si person qëndror i mësimdhënies, por si drejtues i veprimtarisë së nxënësve në klasë dhe orientues i punës së tyre. Mësuesi veçon qartë ato njohuri dhe aftësi të cilat janë të domosdoshme për nxënësin, duke përcaktuar edhe nivelin minimal për të gjithë nxënësit. Në ndërtimin e qëndrueshëm të formimit të dijeve, rol të rëndësishëm luan edhe

integrimi lëndor, që shmang kështu copëtimin e dijeve dhe krijon një bazë solide për përvetësimin e tyre nga ana e nxënësve.

Kjo i aftëson nxënësit që të gjejnë burime të larmishme informacioni dhe të përdorin strategji efektive në përpunimin dhe përdorimin e tij për të analizuar situata problemore dhe për t'i zgjidhur ato duke u mbështetur edhe në mendimin kritik dhe krijues.

Materiali dhe metodat

Punimi ynë i referohet të dhënave të studimit i cili u zhvillua në vitin akademik Prill 2017 - Maj 2018. Kemi kryer studimin e hollësishëm të literaturës dhe kurrikulave të lëndës së Biologjisë që zhvillohet nga klasa e 10^{-të} deri në klasën e 12^{-të} në sistemin tonë arsimor parauniversitar. Gjithashtu kemi studiuar edhe tekste universitare në fushën e faunës dhe ekologjisë. Janë analizuar orët në dispozicion të pjesës së kurrikulës që flet për konceptin e zinxhirëve ushqimorë. Për secilin tekst të kurrikulës Biologji, kemi studiuar secilën temë me kujdes, duke u përqëndruar në temat me konceptet në studim, të cilat i kemi veçuar nga pjesa tjetër e kurrikulës. Për të arritur në një përfundim sa më të saktë dhe objektiv të punimit tonë është realizuar një pyetësor (Anex1). Pyetësi ka 6 pyetje të cilat tregojnë mjaftueshmërinë e orëve dhe metodikën e përdorur për njohjen e zinxhirëve ushqimorë dhe përbërësve të tij, si dhe një pyetje me sygjerime për të përmirësuar metodikën e mësimdhënies për këtë koncept. Kemi përdorur metodikën shkencore të analizimit SPSS të pyetësorve, si një metodë eksperimentale që grumbullon në mënyrë direkte dhe pa ndikim përgjigje të drejtpërdrejta nga vetë nxënësi. Ne kemi listuar pyetje të mbyllura me alternativë zgjedhje, me qëllim grumbullimin e të dhënave sasiore dhe një pyetje me përgjigje të hapur me qëllim grumbullimin e të dhënave cilësore.

Analizimi i përgjigjeve mendojmë se do na tregojë një gjëndje reale të nivelit të kuptimit të njohurive për zinxhirin ushqimor, si dhe kompetencat që fitojnë nga të kuptuarit e këtij koncepti në nivelin e mësimdhënies në ciklin Parauniversitar. Pyetësi u shpërnda në qytetin e Tiranës në Shkollën 'Ismail Qemali' dhe atë të Fushë Krujës në Shkollën 'Shote Galica'.

Duke u mbështetur në kurrikulën e Biologjisë, në pyetësor kemi listuar pyetje të mbyllura, me alternative zgjedhje, me qëllim grumbullimin e të dhënave sasiore dhe një pyetje me përgjigje të hapur me qëllim grumbullimin e të dhënave cilësore. Të intervistuarit kanë plotësuar pyetësorin me përgjigjet e tyre, pa praninë e intervistuesit. Pyetjet ishin standarde, ku u ruajt anonimati i të intervistuarëve. Përzgjedhja e klasave ishte rastësore, po ashtu dhe përzgjedhja nxënësve që e plotësuan atë ishte rastësore. Pyetësi u shpërnda në orën e Biologjisë, rastësisht nëpër rreshtat me nxënës, dhe duke i mbledhur ato në fund të orës. Niveli i suksesit të nxënësve që plotësuan pyetësorin (nota në lëndën e Biologjisë), nuk është marrë parasysh. Kjo metodologji e ndjekur realizon një mënyrë plotësim nga të gjitha nivelet nxënësve, dhe jep përfundime më afër realitetit. Ne përgatitëm 350 pyetësorë, nga të cilët na u kthyen të plotësuar plotësisht

311 pyetësorë, dhe 39 nuk na u kthyen, ose ishin të plotësuar pjesërisht, të cilët në nuk i morëm parasysh në analizën tonë. Nga shkolla Sh. Galica mblodhëm 135 pyetësorë, kurse nga shkolla Ismail Qemali mblodhëm 176 pyetësorë, pasi ka edhe më shumë nxënës.

Rezultatet dhe diskutimi

Pas mbledhjes së pyetësorit, nga analizimi i tij (Anex 1) kemi këto rezultate:

Për pyetjen 1^{-të}, nga analizimi i rezultateve të përgjigjive të alternativave të pyetësorit kemi këto të dhëna për të dy shkollat (Tabela 1 a,b)


Shkolla / alternativa	A	B	C	Total
Nr. nxënësve Sh. Galica	18	54	63	135
Nr. nxënësve I.Qemali	14	88	74	176

Tabela 1.
a) Numri nxënësve sipas shkollave,

Shkolla / alternativa	A	B	C	Total
% . Sh. Galica	13.33%	40%	46.66%	100%
% . I.Qemali	7.95%	50%	42.04%	100%

Tabela 1. b) % e nxënësve sipas shkollave

Më shumë nxënës, 63 nxënës ose 46.6% e tyre të shkollës Sh. Galica



Grafiku 1. Numri i nxënësve sipas shkollave

kanë zgjedhur alternativën C, duke menduar që orët janë plotësisht të mjaftueshme për konceptin e zinxhirëve ushqimorë, dhe më shumë nxënës të

shkollës I. Qemali, 88 nxënës ose 50% e tyre, kanë zgjedhur alternativën B, duke menduar që orët janë të mjaftueshme. Më pak nxënës, 54 nxënës ose 40% e tyre të shkollës Sh. Galica kanë zgjedhur alternativën B duke menduar që orët janë të mjaftueshme, dhe më pak nxënës të shkollës I. Qemali, 74 nxënës ose 42.04% e tyre kanë zgjedhur alternativën C, duke menduar që orët janë plotësisht të mjaftueshme. Vetëm 18 nxënës ose 13.33% e tyre të shkollës Sh. Galica, dhe 14 nxënës ose 7.95% e tyre të shkollës I. Qemali kanë zgjedhur alternativën A, duke menduar që orët janë pjesërisht të mjaftueshme (Grafiku 1).

Nga kjo analizë vëmë re që nxënësit e të dy shkollave, kanë të njëjtin mendim për orët pjesërisht të mjaftueshme, por kanë mendim të ndryshëm ku nxënësit e shkollës Sh. Galica mendojnë që orët janë plotësisht të mjaftueshme dhe të shkollës I. Qemali që mendojnë që janë të mjaftueshme.


Për pyetjen 2^{-të}, nga analizimi i rezultateve të përgjigjive të alternativave të pyetësorit kemi këto të dhëna për të dy shkollat (Tabela 2 a,b)

Shkolla / alternativa	A	B	C	Total
Nr. nxënësve Sh. Galica	13	55	67	135
Nr. nxënësve I.Qemali	36	56	84	176

Tabela 2. a) Numri nxënësve sipas shkollave,

Shkolla / alternativa	A	B	C	Total
% . Sh. Galica	28.88%	40.74%	49.62%	100%
% . I.Qemali	20.45%	31.81%	47.72%	100%

Tabela 2. b) % e nxënësve sipas shkollave



Grafiku 2. Numri nxënësve sipas shkollave

Më shumë nxënës të shkollës Sh. Galica, 67 nxënës ose 49.62% e tyre, dhe më shumë nxënës të shkollës I.Qemali 84 nxënës ose 47.72% e tyre, kanë zgjedhur alternativën C, duke menduar që metodika është plotësisht e mjaftueshme. Më pak nxënës të shkollës Sh. Galica, 55 nxënës ose 40.74% e tyre, dhe më pak nxënës të shkollës I. Qemali, 20 nxënës ose 43.75% e tyre, kanë zgjedhur alternativën B duke menduar që metodika është e mjaftueshme. Vetëm 13 nxënës ose 28.88% e tyre në shkollën Sh. Galica, dhe 36 nxënës ose 20.45% e tyre për shkollën I. Qemali kanë zgjedhur alternativën A, duke menduar që metodika është pjesërisht e mjaftueshme (Grafiku 2).

Nga kjo analizë vëmë re që nxënësit e të dy shkollave, kanë të njëjtin mendim mbi metodikën e përdorur për këtë koncept.

Për pyetjen 3^{-të}, nga analizimi i rezultateve të përgjigjeve të alternativave të pyetësorit kemi këto të dhëna për të dy shkollat: Të gjithë nxënësit e të dy shkollave kanë zgjedhur alternativën A, duke menduar që i zhvillojnë pjesërisht laboratorët. Kjo tregon qartësisht mangësitë që duhen përmisuar në zhvillimin e laboratorëve.

Për pyetjen 4^{-të}, nga analizimi i rezultateve të përgjigjeve të alternativave të pyetësorit kemi këto të dhëna për të dy shkollat (Tabela 3 a,b)


Shkolla / alternativa	A	B	C	Total
Nr. nxënësve Sh. Galica	39	48	48	135
Nr. nxënësve I.Qemali	70	66	40	176

Tabela 3.
a) Numri nxënësve

sipas shkollave

Shkolla / alternativa	A	B	C	Total
% . nxënësve Sh. Galica	28.88%	35.55%	35.55%	100%
% . nxënësve I.Qemali	39.77%	37.5%	22.72%	100%

Tabela 3. b) % e nxënësve sipas shkollave




Grafiku 3. Numri nxënësve sipas shkollave

Më shumë nxënës të shkollës Sh. Galica 48 nxënës ose 36% e tyre, kanë zgjedhur alternativën B ose C, që njohin mjaftueshëm ose plotësisht konsumatorët, ndërsa më shumë nxënësi të shkollës I. Qemali, 70 nxënës ose 40% e tyre kanë zgjedhur alternativën A që nuk i njohin. Vetëm 39 nxënës ose 29% e tyre të shkollës Sh. Galica kanë zgjedhur alternativën A që i njohin pjesërisht ata, kurse më pak nxënës të shkollës të I. Qemali, 66 nxënës ose 37% e tyre kanë zgjedhur alternativën B që i njohin mjaftueshëm. Vetëm 40 nxënës ose 23% e tyre të shkollës I. Qemali kanë zgjedhur alternativën C që i njohin plotësisht (Grafiku 3). Vërejmë se kemi një dallim të qartë midis nxënësve të shkollës I. Qemali, të cilët njohin shumë pak konsumatorë të vendit apo zonës, dhe një njohje më të plotë të tyre nga nxënësit e shkollës Sh. Galica që është një shkollë më afër habitateve natyrore.

Për pyetjen 5^{-të}, nga analizimi i rezultateve të përgjigjeve të alternativave të pyetësorit kemi këto të dhëna për të dy shkollat: Të gjithë nxënësit e të dy shkollave kanë zgjedhur alternativën A, duke menduar që i zhvillojnë pjesërisht ekskursionet. Kjo tregon qartësisht mangësitë që duhen përmirësuar në zhvillimin e ekskursioneve në natyrë.

Për metodikën, nga analizimi i rezultateve të përgjigjeve të alternativave të pyetësorit kemi këto të dhëna për të dy shkollat (Tabela 4). Më shumë nxënës ose 66% e tyre në shkollën Sh. Galica sugjerojnë ekskursionet si metodikë për të kuptuar më mirë konceptet për zinxhirët ushqimorë, 25% e tyre zhvillimin e orëve laboratorike, 5% video, 2% sugjerojnë orë mësimore shtesë dhe me nga 1% përdorimin e posterave. Kurse në shkollën I. Qemali më shumë nxënës ose 65% e tyre, sugjerojnë gjithashtu ekskursionet në natyrë, 14% zhvillimin e orëve laboratorike, 7% zhvillimin e veprimtarive të ndryshme, 5% videot, 11% kërkojnë orë shtesë, 3% më shumë shembujve dhe me nga 1% vizitat në Kopështin Zoologjik dhe takime me ekspertë të fushës (Grafiku 4). Vërehet se ekskursionet shikohen si metodë në të dy shkollat, duke nxjerë si përfundim se kemi mangësi në zhvillimin e tyre.



Shkolla / alternativ a	Ekskursio ne	Laboator	Video	Shembuj	Orë shtesë	Postera	K.Zoolog	Ekspert fshesë	Tota l
% . nxënësve Sh. Galica	66%	25%	5 %	1 %	2%	1 %	0	0	100 %
% . nxënësve I.Qemali	65%	14%	5 %	3 %	11%	0	1 %	1 %	100 %

Tabela 4. a) % e nxënësve sipas shkollave

Përfundime

Në përfundim të këtij studimi, nga analizimi i pyetësorit kemi disa përfundime të rëndësishme.

Më shumë nxënës, 63 nxënës ose 46.6% e tyre të shkollës Sh. Galica mendojnë që orët janë plotësisht të mjaftueshme për konceptin e zinxhirëve ushqimorë, dhe më shumë nxënës të shkollës I. Qemali, 88 nxënës ose 50% e tyre, mendojnë që orët janë të mjaftueshme. Vetëm 18 nxënës ose 13.33% e tyre të shkollës Sh. Galica, dhe 14 nxënës ose 7.95% e tyre të shkollës I. Qemali mendojnë që orët janë pjesërisht të mjaftueshme. Si përfundim nxënësit e të dy shkollave, kanë të njëjtin mendim për orët pjesërisht të mjaftueshme, por kanë mendim të ndryshëm ku nxënësit e shkollës Sh. Galica mendojnë që orët janë plotësisht të mjaftueshme dhe të shkollës I. Qemali që mendojnë që janë të mjaftueshme.

Më shumë nxënës të shkollës Sh. Galica, 67 nxënës ose 49.62% e tyre, dhe më shumë nxënës të shkollës I. Qemali 84 nxënës ose 47.72% e tyre, mendojnë që metodika është plotësisht e mjaftueshme. Vetëm 13 nxënës ose 28.88% e tyre në shkollën Sh. Galicas, dhe 36 nxënës ose 20.45% e tyre për shkollën I. Qemali mendojnë që metodika është pjesërisht e mjaftueshme. Nga kjo analizë vëmë re që nxënësit e të dy shkollave, kanë të njëjtin mendim mbi metodikën e përdorur për këtë koncept.

Të gjithë nxënësit e të dy shkollave mendojnë që i zhvillojnë pjesërisht laboratorët dhe ekskursionet. Kjo tregon qartë mangësitë që duhen përmirësuar në zhvillimin e laboratorëve.

Më shumë nxënës të shkollës Sh. Galica, 48 nxënës ose 36% e tyre i njohin mjaftueshëm ose plotësisht konsumatorët, ndërsa më shumë nxënës të

shkollës I. Qemali, 70 nxënës ose 40% e tyre nuk i njohin. Vetëm 39 nxënës ose 29% e tyre të shkollës Sh. Galica i njohin pjesërisht ata dhe vetëm 40 nxënës ose 23% e tyre në shkollën Tiranë i njohin plotësisht. Vërejmë se keni një dallim të qartë midis nxënësve të shkollës I. Qemali, të cilët njohin shumë pak konsumatorë të vendit apo zonës, dhe një njohje më të plotë të tyre nga nxënësit e shkollës Sh. Galica e cila është një shkollë më afër habitateve natyrore.

66% e nxënësve në shkollën Sh. Galica dhe 65% e tyre e shkollës I. Qemali, sugjerojnë ekskursionet si metodikë për të kuptuar më mirë konceptet për zinxhirët ushqimorë, duke nxjerë si përfundim se kemi mangësi në zhvillimin e tyre.

Mendojmë se zhvillimi i orëve të laboratorëve, dhe ekskursioneve do të rrisi më shumë njohuritë dhe kopetencat e nxënësve për të njohur konceptet e zinxhirëve ushqimorë, si dhe nxënësit e shkollës I. Qemali duhet të kenë më shumë mundësi për njohje reale të konsumatorëve dhe faunës të vendit.

Literatura

Jones M., Jones G. (2016): Biologji 10. Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Pegi, Tiranë: 142-146

Jones M., Jones G. (2016): Biologji 11. Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Pegi, Tiranë: 145-152

Pickering, Ron (2016): Biologji 10. Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Mediaprint

Pickering, Ron (2016): Biologji 11. Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Mediaprint

Ruka, Ethem (2010): Biologji 11me zgjedhje të detyruar. Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Mediaprint